

UNMIK/REG/2006/21
22 prill 2006

RREGULLORE NR. 2006/21

**MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR SHËRBIMET MJEKËSORE
EMERGJENTE TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) të datës 10 qershor 1999,

Në harmoni me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 7 mars 2006 lidhur me Ligjin për shërbimet mjekësore emergjente të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 23 shkurt 2005,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo pushtetin dhe kompetencat e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall Ligjin për shërbimet mjekësore emergjente i miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 02/L-50), që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit, me kusht që fjalët “qytetarët” të zëvendësohet me “banorët” në tërë ligjin. Ky ndryshim do të paraqitet në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar sot, më 22 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm